REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2152/15 Prot. Tiranë, më 30.10.2026

VENDIM

Nr. 139 datë 30.10 2026

"PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË RREGJISTRIT TË PARASHIKIMEVE TË PROKURIMEVE PUBLIKE PËR VITIN 2027, NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS"

Mbështetur në nenin 38, neni 108, 109, të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në Ligjin nr.10296, datë 08/07/2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, në Ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin Publik", " i ndryshuar, në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Mbi Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, në Udhëzimin me nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" të ndryshuar, në Vendimin Qarkullues të Senatit Akademik nr. 90, datë 07.08.2025", në Vendim Qarkullues të Bordit të Administrimit me nr. 44 datë 14.08.2025 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm për vitin 2026-2028 për UST", si dhe referuar kërkesave të depozituara nga Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes shkresë me nr. 1970/1 datë 08.10.2026 dhe Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit shkresë me nr. 1988/1 datë 09.10.2026, për organizimin e modulit "Ski" dhe "Sporte Dimërore" për vitin akademik 2026-2027 dhe 2027-2028, në Relacionin e Administratorit me nr. 2110 prot., datë 23.10.2026, në Vendimin e Rektoratit nr. 127, datë 27.10.2026, Senati Akademik në mbledhjen e datës 30.10.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e Rregjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2027, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, sipas tabelës bashkëngjitur.

2. Ky vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të UST-së.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. AGRON KASA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
ADMINISTRATORI
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 2110 Prot.

Tiranë, më 23.10.2026

Lënda: Kërkesë për miratimin e Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimit Publik për vitin 2027 për "Ofrimin ë Shërbimit të modulit "Ski" për studentët e FSHL dhe modulit "Sporte Dimërore" për studentët e FVFR-së"

REKTORATIT TË UST-SË

SENATIT AKADEMIK TË UST-SË

KËTU

Të nderuar !

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor IAL, në Republikën e Shqipërisë", neni 38, 40, 49, 108, në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në ligjin nr.10296, datë 08/07/2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, në Vendimin Qarkullues të Senatit Akademik nr. 90, datë 07.08.2025", në Vendim Qarkullues të BA Nr. 44 datë 14.08.2025 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm për vitin 2026-2028 për UST", Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM 285 dt. 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, si dhe referuar kërkesave të depozituara nga Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes me nr.

1970/1 datë 08.10.2026 dhe Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit me nr. 1988/1 datë 09.10.2026, për organizimin e modulit "Ski" dhe "Sporte Dimërore" për vitin akademik 2026-2027 dhe 2027-2028, kërkojmë miratimin e Rregjistrit të Parashikimeve të Prokurimeve Publike për vitin 2027.

Mbështetur në strukturën vjetore të procesit mësimor të FSHL-së dhe FVFR-së për vitin akademik 2026-2027 dhe 2027-2028, për modulin "Ski" dhe për modulin "Sporte |Dimërore", FSHL me shkresën nr. 1970/1 datë 08.10.2026 dhe FVFR me shkresën nr. 1988/1 datë 09.10.2026, kanë kërkuar organizimin e këtyre moduleve dhe marrjen e masave për organizimin e tyre për tre shërbimet vijuese:

1. Shpenzime për fjetje;
2. Shpenzimet e ushqimit;
3. Shpenzime për marrje me qera të skive

Për vitin akademik 2026-2027, FSHL kërkon të sigurohet fjetja, ushqimi, marrja e skive me qera, për 163 studentë dhe 12 petagogë, ndërsa për vitin akademik 2027-2028, kërkon të sigurohet fjetja, ushqimi, marrja e skive me qera për sasi të pritshme 195 studentë dhe 12 petagogë për 7 netë/ditë.

Për vitin akademik 2026-2027, FVFR kërkon të sigurohet fjetja ushqimi, marrja e skive me qera, për 195 studentë dhe 12 petagogë, ndërsa për vitin akademik 2027-2028, kërkon të sigurohet fjetja, ushqimi, marrja e skive me qera për sasi të pritshme 195 studentë dhe 12 petagogë për 7 netë/ditë.

Përzgjedhja e procedurës së prokurimit me marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, me kushte të përcaktuara, për realizimin e objektit "Ofrimi i Shërbimit të modulit "Ski" për studentët e FSHL dhe modulit "Sporte Dimërore" për studentët e FVFR-së , ndarë në dy lote, është e argumentuar ligjërisht dhe funksionalisht, duke garantuar eficiencë, cilësi dhe përmbushje të qëllimit publik të institucionit.

Së pari, natyra e shërbimit që kërkohet është e përsëritur dhe sezonale. Aktivitetet e këtyre moduleve zhvillohen në mënyrë periodike (zakonisht çdo vit akademik), duke krijuar nevojën për një instrument fleksibël që mundëson kontraktimin e shërbimeve në mënyrë të vazhdueshme

brenda një periudhe të caktuar kohore. Marrëveshja kuadër i përgjigjet kësaj nevoje duke shmangur zhvillimin e procedurave të shumta të prokurimit për çdo aktivitet të veçantë.

Së dyti, kushtet e realizimit të këtyre shërbimeve janë të qarta dhe të paracaktuara, si: vendndodhja që duhet të jetë malore, infrastruktura, siguria, pajisjet për ski dhe programi mësimor. Kjo bën të mundur përdorimin e marrëveshjes kuadër "me kushte të përcaktuara", ku të gjitha elementet thelbësore të kontratës janë të fiksuara që në momentin e lidhjes së marrëveshjes, duke rritur transparencën dhe parashikueshmërinë.

Së treti, kjo procedurë rrit eficiencën administrative dhe ekonomike. Përdorimi i marrëveshjes kuadër redukton kohën dhe kostot procedurale për autoritetin kontraktor, duke lehtësuar planifikimin dhe menaxhimin e fondeve publike, në përputhje me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit të përcaktuara në legjislacionin për prokurimin publik.

Së katërti, kjo formë prokurimi është në përputhje me parimet themelore të trajtimit të barabartë, transparencës dhe konkurrencës, pasi operatori ekonomik përzgjidhet përmes një procedure konkurruese të hapur, ndërsa marrëveshja kuadër përdoret vetëm si instrument për ekzekutimin e mëtejshëm të kontratave të posaçme.

Referuar nenit nenit 34 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin public" i ndryshuar, nenit 76 pika 1 c) të VKM 285 dt. 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, nisur nga specifikimet teknike të shërbimeve, për zërat: fjetje në hotel, qira për pajisje profesionale, shërbimin e ofrimit të tre vakteve (ushqimi), u bazua në çmimet e kontratës me nr. 3081/15prot datë 27.01.2026 ndërmjet Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe operatorit ekonomik sipas ofertës përkatëse në procedurën me objekt "Ofrimi i modulit të skive për studentët e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes" për vitin 2026 si dhe kontratës me nr. 2000/31 prot datë 14.01.2026 ndërmjet Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe operatorit ekonomik sipas ofertës përkatëse në procedurën me objekt "Ofrimi i shërbimit të modulit sporte dimërore-ski për studentët e Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit" për vitin 2026.

Llogaritja për të dy fakultet do të realizohet duke marrë në konsideratë numrin e studentëve për secilin shërbim si sasi e pritshme për dy vitet 2026-2027 dhe 2027-2028.

MODULI SKI FSHL

Tabela nr.1

Nr	Emertimi	Njwsia	Sasia	Nr studentëve 2026-2027 dhe 2027-2028	Nr pedagogëve 2026-2027 dhe 2027-2028	Totali 2027-2028	Cmimi/njësi pa TVSH "Hotel Park Voskopoja"	Vlera pa TVSH
1	Shpenzime fjetje (hotel)	netë	7	358	24	2,674	2,200	5,882,800.00
2	Shpenzime për ushqim 3 vakte	ditë	7	358	24	2,674	2,250	6,016,500.00
3	Qera për përdorimin e pajisjeve të skive	ditë	7	358	0	2,506	100	250,600.00
	Shuma pa TVSH							**12,149,900.00**
	TVSH 20% (2 dhe 3)							1,253,420.00
	TVSH 6 % (1)							352,968.00
	Totali me TVSH							**13,756,288.00**

MODULI SPORTE DIMERORE FVFR

Tabela nr.2

Nr	Emertimi	Njwsia	Sasia	Nr studentëve 2026-2027 dhe 2027-2028	Nr pedagogëve 2026-2027 dhe 2027-2028	Totali 2027-2028	Cmimi/njësi pa TVSH "Hotel Park Voskopoja"	Vlera pa TVSH
1	Shpenzime fjetje (hotel)	netë	7	390	24	2,898	2,200	6,375,600.00
2	Shpenzime për ushqim 3 vakte	dítë	7	390	24	2,898	2,250	6,520,500.00
3	Qera për përdorimin e pajisjeve të skive	ditë	7	390	0	2,730	100	273,000.00
	Shuma pa TVSH							**13,169,100.00**
	TVSH 20% (2 dhe 3)							1,358,700.00
	TVSH 6 % (1)							382,536.00
	Totali me TVSH							**14,910,336.00**

Referuar Tabelave nr.1 dhe nr.2 për 2 vjet, për të dy fakultetet fondi llogaritet si më poshtë:

Nr	Emertimi	Njwsia	Sasia	Nr studentëve 2026-2027 dhe 2027-2028	Nr pedagogëve 2026-2027 dhe 2027-2028	Totali 2027-2028	Cmimi/njësi pa TVSH "Hotel Park Voskopoja"	Vlera pa TVSH
1	Shpenzime fjetje (hotel)	netë	7	748	48	5,572	2,200	12,258,400.00
2	Shpenzime për ushqim 3 vakte	ditë	7	748	48	5,572	2,250	12,537,000.00
3	Qera për përdorimin e pajisjeve të skive	ditë	7	748	0	5,236	100	523,600.00
	Shuma pa TVSH							**25,319,000.00**
	TVSH 20% (2 dhe 3)							2,612,120.00
	TVSH 6 % (1)							735,504.00
	Totali me TVSH							**28,666,624.00**

Për sa më sipër, bashkëlidhur po ju dërgojmë Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimit publik për vitin 2027 për zërin "Ofrimi i Shërbimit të modulit "Ski" për studentët e FSHL dhe modulit "Sporte Dimërore" për studentët e FVFR-së.

ADMINISTRATOR

Haxhirete Sulaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI I SPORTEVE TIRANË

Autoriteti Kontraktor: Universiteti i Sporteve të Tiranës

Regjistri i Parashikimeve të Prokurimeve Publike viti 2027

Nr	Llogaria	Viti	I ri/ i modifikuar	Objekti i prokurimit	Kontratë, Marrëveshje kuadër	Tipi i kontratës (mall/punë/shërbim/marrëveshje kuadër)	Fondi i llogaritur	Burimi i financimit (buxheti i shtetit, te ardhura, vetëfinancim,etj)	Vlera	Lloji i procedurës së prokurimit/Minikontratë/Amendament kontrate për nevojat e fillim viti	CPV Kod	Koha e planifikuar për shpalljen e procedurës (muaji)	Organi që zhvillon procedurën e prokurimit në rastin e procedurave të përqëndruara
1	6029099	2027	I ri	Ofrimi i sherbimit moduli Ski per studentet e "FSHL" dhe modulit "Sporte Dimerore" për studentët e FVFR	Kontratë	Shërbim	25,319,000	Buxheti	28,666,624	Marreveshje Kuader Tender i hapur	55110000-4 92600000-7 55521200-0	Gjatë vitit 2026	UST